

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjyquese Sadije Selmani, me pjesmarrjen e sekretares juridike Luljeta Luboteni-procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. A nga fshati " " Komuna e Suharekës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/IL.nr.189-5/17 të datës 23.02.2017 e plotësuar me dt.28.02.2017, për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Fatos Ajvazi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.D M nga , me datë 01.03.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:**

## AKTGJYKIM

## I akuzuari:

D. A nga i ati Z. dhe e ëma V. e vajzërisë K, i lindur me në fshatin " " Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, punëtorë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Se me datë 31.01.2017, rreth orës 07:30 minuta, në Prizren, në rrugën " " afër " " , për shkak të mosmarrveshjeve që i akuzuari kishte me të dëmtuarën T U , me të cilën bashkëjeton, fillimisht kishte kërkuar nga e dëmtuara që të kthehet në banesë dhe kur e dëmtuara kishte refuzuar, i njëjti e kishte sulmuar duke e goditur me grushta dhe shqelma nëpër pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe ate: ndrydhje dhe gërvishnje të indeve të buta në regjionin e buzëve të gojës dhe regjionin e parakrahut të djathtë, të përshkruara më përseafërmi si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të Dr.N H. të dt.27.02.2012.

-Këso dore kryen veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4, 7, 17, 41, 42, 43 pika 1.2, 45, 73 dhe nenin 188 par.1 nënpar.1.4 të KP-së, të akuzuarin e gjykon me:

## DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.01.2017 e gjerë me datë 01.03.2017.

E dëmtuara T (R U nga , rruga " " , kati i 4 nr.29, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari D. A obligohet që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe ate: për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej 20 euro dhe në emër të paushallit

gjyqësor të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.189-5/17 të datës 23.02.2017, kundër të akuzuarit D. A. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 paragrafi 1 të KP-së, të plotësuar me dt.28.02.2017, sipas së cilës të akuzuarin në vend të veprës penale të sulmit e ka akuzuar për veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KP-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin fillestar, sipas aktakuzës PP/II.nr.189-5/17 të datës 23.02.2017, e plotësuar me dt.28.02.2017, në të cilën shqyrtim i akuzuari D. A. ka pranuar fajësinë për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KP-së.

Bazuar në pranimin e fajësisë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin fillestar nga pranimi i fajësisë dhe provave tjera, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua, se i akuzuari D. A., me datë 31.01.2017, rreth orës 07:30 minuta, në Prizren, në rrugën "Ullinjtë", afër "Kafene", për shkak të mosmarrveshjeve që i akuzuari kishte me të dëmtuarën T. U., me të cilën bashkëjeton, fillimisht kishte kërkuar nga e dëmtuara që të kthehet në banesë dhe kur e dëmtuara kishte refuzuar, i njëjti e kishte sulmuar duke e goditur me grushta dhe shqelma nëpër pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe ate: ndrydhje dhe gërvishtje të indeve të buta në regjionin e buzëve të gojës dhe regjionin e parakrahut të djathtë, të përshkruara më përseafërmi si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të Dr.N. H., të dt.27.02.2012.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari D. A. i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij avokatin D. M., për shkak së cilës gjykata nuk ka administruar provat, sepse gjatë pranimit të fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pa kushtëzime nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj në bazë të ligjit duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohzgjatje prej 3 (tre) mujve, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana rënduese gjykata ka vlersuar historinë kriminale të akuzuarit, ku gjykata në evidencën e saj mbi të dënuarit ka shënime se i akuzuari D. A. është kryerës i kësaj natyre të veprave penale dhe të veprave tjera ndaj të dëmtuarës së njëjtë dhe se është gjykuar me

aktgjykimi P.nr.228/16, i plotfuqishëm me dt.18.07.2016, mirëpo edhe përkundër dënimit të shqiptuar i njëjti përsëri ka kryer veprë penale ndaj të dëmtuarës. Përpos rrethaneve rënduese gjykata vlerësoi edhe rrethanat lehtësuese: si rrethanat personale të akuzuarit, është i martuar, baba i dy fëmijëve, gjëndjen e tij të dobët ekonomike, pranim e fajësisë nga ana e tij dhe sjelljen korrekte gjatë procesit gjyqësor. Kështu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me veprën penale të kryer dhe është adekuat me përgjegjësinë penale të të akuzuarit me bindje se me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit duke përfshirë preventivën individuale dhe atë të përgjithshme si dhe do të ndikojë në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
P.nr.396/2017, me datë 01.03.2017

Procesmbajtësja

Lujjeta Luboteni

*Luboteni*

Gjyqtarja e vetme gjyquese

Sadije Selmani

*Selmani*

**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

EXR. 4 Aktgjykimet  
3 Fletë origjesh  
1 Fletë e letëshkrimit

21.03.17

*Selmani*